



Ismet Krasniqi

Ismet Krasniqi është student i nivelit master në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci në Universitetin e Prishtinës, me interes të veçantë në qeverisje, politika ndërkombëtare dhe përfaqësim të rinjve. Ai ka përfunduar studimet bachelor në Shkenca Politike në Fakultetin Filozofik, duke ndërtuar një bazë të fortë akademike në analizën politike dhe institucionale.

Gjatë përvojës së tij profesionale, ai ka punuar si Asistent Projekti dhe Hulumtues i Ri, ku ka kontribuar në kërkime mbi fuqizimin e rinjve dhe statusin NEET përmes analizës së të dhënave dhe organizimit të aktiviteteve zhvillimore në Kosovë. Po ashtu, ka qenë pjesë e stafit mbështetës në Komisionin për Arsim, Rini, Shkencë dhe Teknologji në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke u angazhuar në përgatitjen e dokumenteve zyrtare dhe mbështetjen e proceseve parlamentare.

Ismeti ka një përfshirje të gjerë në jetën studentore dhe organizimin rinor. Ai aktualisht është anëtar i Senatit të Universitetit të Prishtinës dhe Kryetar i Organizatës Studentore “Reforma”. Më herët, ka shërbyer si deputet në Parlamentin Studentor dhe si Kryetar i Këshillit të Studentëve në Fakultetin Filozofik, ku ka përfaqësuar interesat e studentëve dhe ka kontribuar në avancimin e jetës akademike.